



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 313 Prot.

Tiranë, më datë 19.04.2022

VENDIM
Nr. 104, datë 19.04.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.04.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të ri kërkimor-shkencor “Varret shkëmbore të Matit”, dhe territori i tyre – studime arkeologjike në pellgun ujëmbledhës, të Qendrës për Zhvillimin e Trashëgimisë Antiko-Mesjetare Shqiptare, Universiteti i Durrësit, me aplikues dhe drejtues projekti Z. Ols Lafe;
2. Pas përfundimit të fazës së parë, e cila lidhet me studime përnjohëse të zonës, e parashikuar të realizohet brenda vitit 2022, drejtuesi i projektit duhet të depozitojë pranë IKTK një kopje e dokumentacionit të terrenit;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

